Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Br./Br. 81/17, 86/17, 91/17
Datë/Datum 02.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 81/17
86/17
91/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 paragrafi 2, pika 2.16, nenit 106, nenit 131 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje prej **Ekrem Salihu- Kryetar, Tefik Sylejmani-Referues, Goran Milenković Anëtar, Nuhi Paçarizi-Anëtar** dhe **Blerim Dina-Anëtar,** duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 81/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli në Deçan, të cilin e përfaqësoj Jahir Likaj, ankesës me nr. të protokollit 86/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"Euroasphalt"** me seli në Gjakovë, të cilin e përfaqësoj Fatos Deva dhe ankesës me nr. të protokollit 91/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **"Drini Company"sh.p.k.** me seli në Prizren, të cilin e përfaqësoj Fatmir Gashi, kundër autoritetit kontraktues-Komuna e Gjakoves-përfaqësuar nga znj.Albana Bakalli, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë",** me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Gjakovës, në seancën e dt. 24 prill 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** ankesa e operatorit ekonomik **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli në Deçan, me nr. të protokollit 81/17 dhe ankesa e operatorit ekonomik **"Euroasphalt"** me seli në Gjakovë, me nr. të protokollit 86/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë",** me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, të shpallur nga autoritetit kontraktues Komuna e Gjakovës, si pjesërisht të bazuara.

II. **Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik **"Drini Company"sh.p.k.** me seli në Prizren, me nr, të protokollit 91/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë",** me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Gjakovës, si e bazuar.

III. **Anulohet,** vendimi i autoritetit kontraktues- Komunaës së Gjakovës, njoftim për dhënie të kontratës për aktivitetin të prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë",** me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim .

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

VI. Operatorit ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli në Deçan, operatrorit ekonomik ankues **"Euroasphalt"** me seli në Gjakovë dhe operatorit ekonomik **"Drini Company"sh.p.k.** me seli në Prizren, konform nenit 118 pika 3, i'u kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VII. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 33 pika 6 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës më dt. 29 dhjetor 2016, ka publikuar *Njoftim për kontratë,* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për aktivitetin e prokurimit "**Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, kanë ofertuar nëntë (9) operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues 2 (dy) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 7 (shtatë) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk kanë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim, operatori ekonomik OE "Lika Trade" sh.p.k. me seli Deçan, OE "Euroasphalt" sh.p.k me seli në Gjakovë dhe OE N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. me seli në Prizren me dt. 15 mars 2017 dhe 24 mars 2017, në afatin e paraparë ligjor kanë parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Operatori ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli Deçan, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje te nenit 59 dhe nenit 60 të LPP-së

Operatori ekonomik ankues "Euroasphalt" sh.p.k me seli në Gjakovë, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7, nenit 27, nenit 28 dhe nenit 59 të LPP-së, si dhe nenit 20 të UOPP.

Operatori ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. me seli në Prizren, pretendon se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të nenit 7, nenit 27, nenit 29, nenit 59, nenit 69 dhe nenit 72 të LPP-së, si dhe nenit 18, nenit 39, nenit 41 dhe nenit 45 të Rregullave dhe UOPP.

Ankesat e operatorve ekonomik janë të afatëshme dhe të parashtruara nga ana e personave kompetent.

Ankesat e OE **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli në Deçan dhe OE **"Euroasphalt" sh.p.k** me seli në Gjakovë janë pjesërisht të bazuara.

Ankesa e OE **N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k.** me seli në Prizren, është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 03 prill 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues, me datën 13 prill 2017, i dorëzon, panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimet ankimore të OE "Lika Trade" shpk, që kanë të bejnë me arsye e eliminimit të dhëna nga autoritetit kontraktues, sqaron se nuk qëndrojn për arsye se operatori ekonomik ankues, nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, sepse ka ofruar planin dinamik për kryerjen e punëve, prej dt. 05 shkurt 2017 deri me dt. 25 qershor 2017, apo ka dhenë edhe përshkrimin e punëve që do të kryhen, duke specifikuar si në vijm: Rruga 50 ditë; Kanalizimi atmosferik 20 ditë; Kanalizimi fekale 20 ditë; Ujësjellësi 25 ditë; Elektrika 25 ditë; Sinjalizimi horizontal dhe vertikal 10 ditë dhe Dislokimi i instalimeve të ngrohjes 30 ditë, ndërsa është kërkuar "*Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur jo më shumë se 100 ditë kalendarike*".

Po ashtu nuk ka ofruar dëshmi lidhur më kërkesën "*Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal*, por vetëm Deklaratë per dokumetete që do të dorëzohen në rast se shpallën fitues, ku deklaron se në rast së shpallet fitues do të dorëzoj "*Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal*".

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë,** ku thuhet: "*Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pozicioni 9.1 i FDT-së "Autorizimin e prodhuesit ose dilerit për Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal", ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar DEKLARATË, nuk mund të konsiderohen si AUTORIZIME*", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ckonform nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarim nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, me dt. 07.03.2017, ndërsa operatori ekonomik me dt. 08 mars 2017, ka dorëzuar në autoritet kontraktues Deklaratë në lëshuar nga "VERNISOL" Itali, ku ndër të tjera thuhet: shoqëria "IDK KONSTRUKSION" shpk Tiranë, është distributor zyrtarë i yni për "Bojra dhe aksesor për sinjalitik rrugore horizontale". Po ashtu, edhe nga kompanai italiane "*TAMBURRINI*

ALESSANDRO" ka ofruar Deklaratë ku ceket: shoqëria "IDK KONSTRUKSION" shpk Tiranë, është distributor zyrtarë i yni për "Sinjalistiken rrugore vertikale dhe aksesoreve të ndryshem".

Pretendimi i operatorit ekonomik ankus **"Euroasphalt" sh.p.k . Gjakovë,** ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkleje të nenint 28 të LPP-së respektivisht aty ku ceket : "*Autoriteti Kontraktues tek Aneksi 1 - Specifikacioni Teknik i Dosjes së tenderit tek kreu V - Elektrika në pozicionin / rreshtin 98 të tabeleës ka bërë favorizimin e produktit (ndërprerësve) AS-150A të prodhuesit* ***Shneider (Schneider Electric),*** *duke cekur kjartaz emrin e brendit e cila nuk është e lejuar, në këtë rast ka bërë diskriminimin e operatorëve ekonomik pasi që jo të gjithë mund të jenë distributor të kësaj kompanie për furnizim të produkteve të saja",* bazuar ne Aneksin 1-Specifikimin teknike të detyrushem, ekspertja shqyrtuese sqaron se ne pozicionin 98, autoriteti kontraktues ka specifikuar si në vjim: *Furnzimi i transporti montimi i ndërprerësve AS-150A-Shneider*, që nënkupton se në rastin konkret autoriteti kontraktues ka cekur emrin e prodhuesit, që është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 të LPP-së dhe nenin 20.8, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-A01.

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, "*Katalogët e dërguara me 13.03.2017 te prodhueseve ITALIAN, janë ne gjuhen Italiane, qe është ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe UOPP, pasi qe gjuha italiane nuk është gjuhe zyrtare, dhe nuk e di se si komisioni i vlerësimit i ka pranuar këto dokumente kur janë ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe se si ka arritur ta bëjë një vlerësim te produktit te ofruar*", ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalogun për sinjalistik vertikale nga kompania "VERNISOL" Itali, në gjuhën italiane me shenja të komunikacionit, dhe katalogun nga kompania "IDK Konstruksion" sinjalistik vertikale në gjuhën shqipe, mirëpo nuk është dhënë përshkrimi teknik, ashtu siç është dhënë në specifikimin teknik te Përshkrimi-sinjalizimi horizontal dhe Përshkrimi-sinjalizimi vertikal.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 13 paragrafi 4 të LPP-së sqaron: "*Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze*".

Sa i pëket pretendimit të operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku ndër të tjera thuhet: "*OE i rekomanduar për kontratë si ne dosje te tenderit edhe ne sqarime shtese te datës 08.03.2017 dhe 13.03.2017 ka dështuar te ofroje produkt i cili i përmbush kërkesat minimale te dosjes se tenderit. Ka ofruar trup ndriçues nga prodhuesi GE lighting tipi SLBT, i cili jetëgjatësinë e llampes ndriçuese e ka > 64 000 ore, (dështmia 9) kurse ne dosje te tenderit eshte kërkuar te jete > 100 000 ore",* ekspertja shqyrtues bazuar ne oferten e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsy se autoriteti kontraktues në Aneksin 1- Specifikimet teknike të detyrushme te Karakteristikat teknike të ndriçmit, në nr.rendor 6. ka specifikuar: Jetëgjatësia e lampë ndriçuse LED >100.000, ndërsa në operatroi ekonomik I rekomanduar për kontratë ka ofruar GE lighting tipi SLBT, 64000h.

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet: *"Ne po të njëjten pikë të Ankesit për specifikimet teknike të detyrueshme janë kërkuar Raporetet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (te dorëzohen me ofertën) Operatroi ekonomik i rekomanduar për*

kontratë nuk ka ofruar asnjë certifkatë të atestimeve të cilat janë kërkuar të dorëzohen me ofertë", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes përgjigjeve ne pytjet e parashtuar, ka specifikuar se lidhur me kërkesën e specifikuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së: Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues).

Ndërsa, ekspertja shqyrtuse në shkresat e lëndës respektivisht ne ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk ka hasur dëshmi se ka ofruara certifikata EN dhe protokolle të testitmti për produktet e ofruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, si dhe duke pasur parasysh faktin se autoriteti kontraktues në Aneksin 1- Specifikimin teknike të detyrushem, ne pozicionin Nr. 98, ka cekur emrin e prodhuesit, gjë që është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 të LPP-së dhe nenin 20.8, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-A01, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues "Lika Trade" sh.p.k. – Deçan, ta refuzoj si të pabazuar, ankesën e operatorit ekonomik ankues "Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë, ta aprovoj si pjesërisht të bazuar, dhe ankesën e operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ta aprovoj si të bazuar, ndërsa lënda ta kthehej në Ritenderim.

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, përmes parashtresës me shkrim të dt. 20 prill 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 13 prill 2017.

Operatori ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.p.k.** me seli në Deçanë, përmes parashtresës me shkrim të dt. 17 prill 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 13 prill 2017.

Operatori ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k** me seli në Gjakovë, përmes parashtresës me shkrim njofton panelin shqyrtues se pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 13 prill 2017.

Operatori ekonomik ankues **N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k.** me seli në Prizren, përmes parashtresës me shkrim të dt. 18 prill 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues të dhëna në raportin e ekspertizës të dt. 13 prill 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik ankues, raportin e ekspertes shqyrtues të dt. 13 prill 2017, parashtresa e autoritetit kontraktues dhe parashtresat e operatorëve ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues si dhe deklaratat e palëve gjatë seancës dëgjimore.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues "**Lika Trade**" z. Lika, gjatë seacës dëgjimore deklaroj: qëndrojmë pran gjitha pretendimeve tona ankimore dhe nuk pajtohemi me rekomandimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues.Po ashtu nuk pajtohemi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues, ku mund

të themi me përgjegjësi të plotë dhe mbështetur në LPP se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, kur na ka eliminuar në mënyrë të pa drejt dhe jo ligjore dhe ka shpall fitues një operator ekonomik me çmim mbi 60.000€ më të shtrejtë, kështu ne jemi eliminuar për arsye se plani dinamik kinese nuk keni ofruar si duhet, mirëpo ne kemi ofruar ashtu siç e ka kërkuar autoriteti kontraktues në kriteret e vet të përcaktuara e që mund të shihet në ofertën tonë.

Po ashtu për kriterin tjetër që vet i ka kërkuar që certifikatat EN të sjellen pasi që operatori ekonomik të shpallet fitues para nënshkrimit të kontrattës, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi se këto dy kriteret nuk i ka respektuar vet autoriteti kontrakutes. Mundë të dëshmojmë me shkresë të autoritetit kontraktues në përgjigje të OE thuhet "vlenë për OE fitues- duhet të dorëzohen pas rekomandimit për kontratë, me rastin shpalljes fitues të OE". Ne mbështetur në dispozita ligjore përmbushim këto dy kritere, jemi si operator ekonomik me çmim më të ulët i përgjegjshëm mbi 60,000.00€.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesi e operatorit ekonomik ankues, plani dinamik është kërkuar 100 ditë kalendarike, komisioni ka konstatuar se ju keni ofruar plan dinamik prej 140 ditëve, do thotë keni tejkaluar kërkesën e autoriteti kontraktues, a është ky konstatim i komisionit i drejt apo jo.

Në përgjigje përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, z.Likaj deklaroj: me përgjegjësi të plotë deklaroj se siç shihet në ofertë origjinale OE "Lika Trade" ka ofruar plan dinamik 100 ditë, dhe do doja të sjellet oferta që ta shihni edhe vet.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Likaj deklaroj: U vërejt qartë se plani dinamik është prej 100 ditë, dhe shihet qartë se autoriteti kontraktues ka rënë në kundërshtim me vete, për derisa operatori ekonomik i rekomanduar për kotnratë fare nuk ka dëshmuar certifikatat EN, ato janë të mundura të dorëzohen pas shpaljes së fituesit, ne mund të kërkojmë rivlerësim dhe të zbatohet neni 72 i LPP-së, ku mund të ofrojmë certrifkatat edhe me 150000 or pune, dhe të mos dëmtohet buxheti.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi: duke besuar gjithmonë në ndarjen e drejtësisië nga ky panel kërkojmë që të respektohet ligji dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, njëkohësisht kërkojmë që ndaj AK-KK Gjakovë të merren masa ndëshkeuse siç thotë ligji.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k**, z.Deva, gjatë séances dëgjimore, deklaroj: mbështesim dhe qëndrojmë pranë ankesës tonë të deponuar në OSHP. Po ashtu njëherit mbështesim opinionin e ekspertit shqyrtues, dhe propozimin që ky aktivitet të shkoj në **ritender**.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues **N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k.** me seli në Prizren, gjatë séances dëgjimore, z.Gashi deklaroj: në ankesën tonë në mënyrë të detajuar i kemi parqitur pretendimet tona ankimore duke argumentuar secilën shkelje të autoriteitit kontraktues me rastin e vlerësimit të këtij projekti. Gjitha pretendimet tona në mënyrë profesionale i ka vërtetuar edhe ekspertja duke klasifikuar ankesën tonë tërësisht të bazuar.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në vazhdim të prezantimit theksoi, shkurtimisht do prezantoj shkeljet e autoritetit kontraktues.

Në Aneksin 1-Specidfikikmet teknike pika 5, specifikimi teknik elektrik, në pikën 16 të tabeles nga autoritetit kontraktues janë kërkuar raportet e testimit për kompatibilitet me standardet EN. Shprehimisht është shënuar se këto duhet dorëzuar me ofertë. Gjithsej janë 10 certifikata EN, janë kërkuar nga vet autoriteti kontraktues. Asnjë nga këto nuk është sjell nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Nuk dimë se si mundet kërkesat që vendos vet autoriteti kontraktues të mos i respektoj. Këtë mund ta vëtetoni duke pyetur eksperten dhe vet AK-në. Mungesa këtyre dokumenteve është vërtetuar edhe nga ekspertja në ekspertizën e saj. Autoriteti kontraktues është dashtë ta shpall të papërgjegjshëm sipas nenit 67 të LPP-së, ku thuhet autoriteti kontrakutes diskualifikon çdo tenderues që nuk paraqet certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar.

Për më tepër në specifikacion teknik të detyrueshëm jetë gjatësia trupave ndriçues është kërkaur të jetë 100.000 orë, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofrua trupa ndriçues me jetëgjatësi 64.000€. në këtë rast autoriteti kontraktues ka shkel nenin 59 të LPP-së.

OE i rekomanduar ka ofruar katalogje në gjuhë Italiane, gjuhë jo zyrtare kundër nenit 13 par.4 të LPP-së, pasi dokumentet duhet të jenë në gjuhë Shqipe, Serbe ose Angleze. Po ashtu operatori ekonomik i rekomanduar ka ofrua katalogje të gypave të ujsjellësit nga prodhues të ndryshëm për të njëjttin pozicion. Me këtë rast ka ofruar variant, ndërsa në dosje të tenderit pika 4.1 të FTD shkruan "variantet nuk autorizohen".

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në fund të prezantimit shtoi, pas gjitha këtyre shkeljeve të vërtetuara edhe nga ekspertja shqyrtuese kërkojmë nga paneli të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës dhe lëndën ta kthej në Rivlerësim, pasi është e paarsyeshme të merr për bazë pretendimin e operatorit ekonomik e se janë përdor emra të produkteve, kur dihet se vlera e atij produkti "ndëprrerësi Schneider" është 20 euro. Pra ne kërkojmë që lënda të tehet në Rivlerësim.

Përfaqësuesja e autoritetit kontraktues Komunës së Gjakovës znj.Bakalli, gjatë seancës dëgjimore deklaroj: nuk pajtohem me mendimin e ekspertit për analizën e pretendimeve ankimore dhe assesi me rekomandimin për ritenderim.

Sa i përket sqarimit Nr. 1 të eksperti pajtohemi plotësisht. Po ashtu edhe për sqarimin Nr. 2 dhe Nr. 3 për ankesën e OE "Lika Trade", AK-së KK Gjakovë pajtohet plotësisht me sqarimet e dhëna nga ekspertja shqyrtuese.
Ndërsa sa i përket Sqarimit Nr. 4, 5, 6 dhe 7 të ekspetit shqyrtues për ankesën e OE "EuroAsphalt", autoriteti kontraktues nuk pajtohet me mendimin ekspertit për shkak se bazuar ne nenin 111 par.1.5 të LPP-së, OE "EuroAsphalt" nuk gëzon të drejtën ankimore, pasi i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat minimale të dosjes dhe është operator ekonomik i papërgjegjshëm.

Si dhe nuk ka asnjë kuptim të pretendohet për shkelje procedurale për specifikacione teknike pasi që OE "Euroasphalt" me rastin e aplikimit në tender ka pranuar kushtet e paraqitura nga AK-KK Gjakovë. Në rast të mospajtimit me kushtet e tenderit ka mund konform nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, të parashtroj kërkes 5 ditë para afatit për dorëzim të ofertës, të drejtë që mundet të shfrytëzoj çdo operator ekonomik.

Në vazhdim të prezantimit përfaqësusja e autoritetit kontraktues znj.Bakalli:" theksoi, OE "Euroasphalt" nuk ka parqitur asnjë fakt se është i përgjegjshëm dhe ka interes juridiko material, faktikisht është pajtuar me këtë aktivitet dhe raportin e komisionit të vlerësimit. Tani kur i njëjti nuk është shpall fitues e konteston procedurën e këtij aktivitetit të cilën e ka aprovuar fillimisht dhe ofertuar me këto kushte të autoritetit kontraktues. Nga çka u tha më lart KK Gjakovë kërkon nga paneli që ankesën e OE "EuroAsphalt" ta refuzoj si të palejuar pasi nuk ka interes juridik material edhe është i papërgjegjshëm. Plani dinamik i këtij operatori ekonomik është prej 100 ditë, nuk e ka cek as pune as kalendarike, dhe java e tij ka qenë 5 ditë. Plani dinamik kalendarik duhet të jetë java prej 7 ditë.

Përfaqësusja e autoritetit kontraktues znj.Bakalli lidhur me sqarimi Nr. 8 deri 14 të ekspertit për OE "Drini Company", theksoi se autoriteti kontraktues nuk pajtohet me mendimin e ekspertit, pasi komisioni profesional i AK-së dhe komisioni nga anëtaret e DEMOS ka ekzaminuar dhe vlerësuar gjitha faktet dhe dokumentacionet e operatorve ekonomik pjesëmarrës dhe OE "Pevlaku" i rekomanduar par kontratë, i njëjti ka plotësuar kërkesat minimale administrative teknike, si me rastin e ofertimit edhe për OE fitues.

Sa për standardet EN, është të standarizoj rregullat teknike dhe ligjet brenda tregut të vetm evropian i lejuar në 93. Për aq sa mundet standardet ISO ekzistuese duhet përgjithësisht të miratohen si standard EN në formë të pandryshuar. Dallimi mes ISO dhe EN, është që pas vendimit të këshillit evproian, standardi EN duhet miratohen pa ndryshim në shtet anëtare, dhe të njëjtën kohë standardet kombëtare duhet të hiqen. ISO standardet janë zhvilluar si standarde ndërkombëtar ndërsa EN si rajonal. Prandaj ISO standardet janë në përputhje të plotë me EN standardet.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar jetëgjatësi të trupave ndriçues 100.000 orë, OE fitues ka ofruar më shumë se 64.000 orë. Në katalog është deklaruar se tipi L90 ka jetëgjatësi 90.000 orë pune. Duhet të theksohet se është bërë analiza mbi këtë jetëgjatësi, duke i nisur në faktin se ofertuesi në katalog ka dhënë një jetëgjatësi 90.000 orë pune, dhe për lampat me tension 240 volt, ndërsa për kërkesën tonë për 220 volt mund të realizoj lampa deri në 100.000 orë pa ndonjë problem teknologjik.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dokumente në gjuhë italiane dhe gjuhë shqipe, katalogjet e ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë janë në gjuhë italiane.
Në fund të prezantimit përfaqësusja e autoritetit kontraktues i propozojë panelit shqyrtues të OSHP-së që vendimi i autoritetit kontraktues të mbetet në fuqi dhe asesi të mos ritenderohet, pasi ky është donacion i qeverisë Zvicrrane dhe nëse kjo procedurë nuk përfundo tani këtë projekt nuk do ata relazojmë pasi janë afatet e caktuara për marrjen e fondeve".

Ekspertja shqyrtues deklaroj: sa i përket çështjes së planit dinamik të OE "Lika Trade", OE ankues ka ofruar planin dinamik mbi 100 kalendarike dhe njëkohësisht është i papëgjegjshëm. OE "Lika Trade" po ashtu nuk ka prezantuar autorizim nga prodhuesi apo dileri i autorizuar pë pajisje elektrike turpa ndriçues, sinjalizim horizontal dhe vertikal. Në neni 9.1 dhe 9.2 të FTD-së te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale është kërkuar autorizim origjinal i prodhuesit ose dilerin për pajisje, dëshmi ka qenë autorizimi i prodhuesit ose dilerit. Operatori ekonomik ankues ka ofruar deklaratë ku thuhet se këto dokumente do ofrohen në rast se shpallen fitues. Ky krierer ka qenë kriter i kualifikimit të operatorve ekonomik.

OE "EuroAsphalt" ka kontestuar se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar Autorizim të prodhuesit apo dilerit për për Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal, në rastin konkret operatori ekonomik i rekomanduar ka ofruar autorizimin nga dileri i autorizuar "IDK KONSTRUKSION" Tiranë, ku autoriteti kontraktues konfrom nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarim nga operatori ekonomik, dhe me këtë rast operatori ekonomik ka ofruar deklaratën e lëshuar nga "Vernisol" nga Italia ku thuhet se shoqërisa "IDK KONSTRUKSION" është distributor zyrtar i ynë për sinjalistikë rrugore horizontale.

Në vazhdim të prezantimit ekspertja shqyrtuese znj.Bullatovci sqaroj se OE "EuroAsphalt", në ankesë nuk ka pas asnjë pretendim me cilin pretendon se ai është i përgjegjshëm, të gjitha pretendimet ankimore në ankesë kanë qenë për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Pretendim tjetër ankimor lidhur me shkeljen e nenit 28 të LPP-së, pasi që autoriteti kontraktues ka përmend emrin e prodhuesit në specifikim teknik tek pozicioni Nr. 98- Furnizimi, transporti montimi i ndërprerësve AS 150 A Schneider, ekspertja shqyrtues sqaron se ky pretendim qëndron pasi është përmendur emri prodhuesit në pozicion nr. 98, dhe kjo është e ndaluar me nenin 28.7 të LPP-së.

Në pytjen e Kryetarit të panelit shqyrtues se a ka parashtruar ankesë gjatë fazës së tenderimit operatori ekonomik ankues lidhur me pretendimin ankimore se është shkelur nenin 28 i LPP-së, ekspertja shqyrtues deklaroj: afatet ligjorë për ankesë dihen, si për specifikime teknike ashtu edhe për kritere, mirëpo në rastin konkret operatori ekonomik e ka përmend si pretendim ankimorë dhe si eksperte e rastit jamë e obliguar të trajtoj si pretendim ankimorë. Operatori ekonomik është dashtë ta ngritë si pretendim ankimorë para afatit për dorëzim të ofertave mirëpo nuk shoh të keqe që edhe tani të konsatohet sheklja derisa ekziston.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të OE "Drini Company", njëra nga ato është çështja autorizimit të podhuesit për sinjalistik, sipas nenit 72 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka kërkaur sqarime nga operatori ekoomik i rekomanduar për konratë dhe jani ofrua sqarimet.

Çështja e katalogjeve u sqarua më herët, OE i rekomanduar për kontratë një katalog e ka ofruar në gjuhë italiane për sinjlastikë Vertikale nga "Vernisol" dhe katalogun nga "IDK Konstruksion" në gjuhë Shqipe. Sipas nenit 13 paragrafi 4 të LPP-së, një operator ekonomik mund të paraqes një tender ne një aktivitet të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe apo Angleze, dmth nuk specifikohet gjuha italiane.
Lidhur me jetëgjatësisë së lampës, është kërkuar 100.000 orë, ndërsa operatori ekonomik rekomanduar për kontratë ka ofruar 64.000 orë.

Po ashtu edhe pretendimi i operatorit ekonomik ankues që ka të bëjë me certifikatat EN, në oferten e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk kam has se ka ofruar dëshmi për certifikatat EN për produktet e ofruara as për protokollet e testimit për produktet e ofruara.

Në vazhdim të prezantimit ekspertja shqyrtuese sqaroj se janë edhe disa pretendime ankimore për formularë të tenderit Pjesa II, mendoj se ky është një lëshim nga ana e operatorit ekonomik, edhe pse autoriteti kontraktues në raportin e vlerësimit te shumica e operatorve ekonomik e ceke si arsye të eliminimit për këtë pikë, mirëpo për mendimin tim kjo mund të konsiderohet devijim i vogël pasi që nuk ka ndërhyrje në paramas dhe parallogarit nga ana e operatorit ekonomik.

Në fund të prezantimit ekspertja shqyrtues deklaroj se qëndron pranë raportit të ekspertizës, të dt. 13 prill 2017.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Lika Trade"** me seli në Deçan, lidhur me arsyet e eliminimit të dhëna nga komisioni i vlerësimit i autoriteti kontraktues, paneli shqyrtues bazuar ne sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore konsaton se nuk qëndron pretendim i operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, sepse ka ofruar planin dinamik për kryerjen e punëve, prej dt. 05 shkurt 2017 deri me dt. 25 qershor 2017, që i bie më shumë se 100 ditë kalandarike, si dhe nuk ka ofruar dëshmi lidhur më kërkesën "*Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal*, por vetëm Deklaratë per dokumetete që do të dorëzohen në rast se shpallën fitues, ku deklaron se në rast së shpallet fitues do të dorëzoj "*Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal*", andaj më të drejtë është vlerësuar si operator ekonomik i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k** me seli në Gjakovë, ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar ne sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore konsaton se nuk qëndron pretendim i operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesat e kërkuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, sepse ka ofruar planin dinamik për kryerjen e punëve 100 ditë pune, kurse ne dosjen e tenderit është kërkuar 100 ditë kalandarike, andaj me të drejtë është vlerësuar si operator ekonomik i papërgjegjshëm nga autoriteti kontraktues.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k** me seli në Gjakovë, ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se nese operatori ekonomik ankues ka konsideruar se autoriteti kontraktues ka bërë shkleje të nenit 28 të LPP-së, duke përmendur emrin e prodhuesit në specifikim teknike, është dashur që në harmoni me nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, të parashtoj kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues si shkallë e parë, e jo një gjë të tillë ta bëjë pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave respektivisht publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, që rezulton se ka parashtruar ankesë lidhur me pretendimin në fjalë jashtë afatit ligjor.

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet : "*Katalogët e dërguara me 13 mars 2017 te prodhueseve ITALIAN, janë ne gjuhen Italiane, qe është ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe UOPP, pasi qe gjuha italiane nuk është gjuhe zyrtare*", paneli shqyrtues konsaton se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsy se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalogun për sinjalistik vertikale nga kompania "VERNISOL" Itali, në gjuhën italiane me shenja të komunikacionit, që eshte ne kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të LPP-së, ku thuhet "*Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze*".

Pretendimi i operatorve ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se

qëndrojn për faktin se vlerësimi i ofertave nuk është bërë konform nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1. të LPP-së, ku thuhet se kontrata publike do ti epet, vetëm pasi të bëhet vlerësim i tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit dhe specifikimit teknik të specifikuara në njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit, ndërsa në rastin konkret operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar Jetëgjatësia e lampë ndriçuse LED >100.000, ashtu siç janë kërkuara në specifikimin teknike, por e ka ofruar "GE lighting tipi SLBT, 64000h".

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues "Drini Company", ku thuhet: *Në Ankesin për specifikimet teknike të detyrueshme janë kërkuar Raporetet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (te dorëzohen me ofertën) Operatroi ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë certifkatë të atestimeve të cilat janë kërkuar të dorëzohen me ofertë,* paneli shqyrtues bazuar ne sqarimet e dhëna gjatë senaces dëgjimore sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsy se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, lidhur me kërkesën e specifikuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së ku kërkohet: *Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues),* nuk ka ofruara dëshmi për certifikata EN dhe protokolle të testitmti për produktet e ofruara, konform kërkesës së FTD-së.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertes shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorve ekonomik ankues, parashtresës së operatorit ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.p.k.**, parashtresës së operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k**, parashtresës së operatorit ekonomik ankues **"Drini Company"**, parashtresës së autoritetit kontraktues të dt. 16 janar 2017 konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, nuk ka respektuar nenin 7 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Ekrem Salihu

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE"Lika Trade" sh.p.k. me seli në Deçan
1x1 ekzemplar- OE "Euroasphalt" sh.p.k me seli në Gjakovë
1x1 ekzemplar- OE "Drini Company" me seli në Prizren
1x1 ekzemplar - AK –Komuna e Gjakovës
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së